

KUVENDI I KOSOVËS CKYPSTIHA KOCOBA ASSEMBLY OF KOSOVO

Ligji Nr. 02/L-133 dhe
Ligji Nr. 03/L-155

PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESIT NË USHTRIMIN E FUNKSIONIT PUBLIK

Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të kreut 9.1.26, pika (a) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9, datë 15 maj 2001) dhe me qëllim të rregullimit të konfliktit të interesit publik e atij privat të ushtruesve të funksioneve publike,

Miraton këtë:

LIGJ PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESIT NË USHTRIMIN E FUNKSIONIT PUBLIK

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është parandalimi i konfliktit ndërmjet interesit publikë dhe interesit privatë të zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik.

Neni 2 Objekti

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave, subjekteve, përgjegjësive dhe kompetencave për identifikimin, trajtimin dhe zgjidhjen e rasteve të konfliktit të interesit publik dhe interesit privat të zyrtarit gjatë ushtrimit të funksionit publik.

Neni 3 Fushëveprimi i ligjit

Dispozitat e këtij ligji përcaktojnë rregulla të detyrueshme për t'u zbatuar nga çdo zyrtar, kur ai merr pjesë drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë, në një vendimmarrje gjatë ushtrimit të funksionit publik.

Neni 4 Përkufizimet

Për nevojat dhe qëllimin e këtij ligji përkufizimet e mëposhtme kanë këtë kuptim:

“Interes publik” nënkupton besimin dhe pritjen e publikut për sa i përket vendimmarrjes së paanshme dhe të drejtë të zyrtarëve në ushtrimin e funksionit publik.

“Interes privat” nënkuptojmë, interesin privat pasuror ose personal jo pasuror të zyrtarit që mund të ndikojnë në vullnetin e tij në vendimmarrje gjatë ushtrimit të funksionit publik.

“Konflikt i interesit” nënkuptojmë konfliktin e interesit publik dhe interesit privat të zyrtarit në kuptim të nenit 7 të këtij ligji.

“Person i afërt me zyrtarin” është bashkeshorti ose personi që bashkejeton me zyrtarin, te afermit ne vije te drejte te gjakut pa kufizime, adaptuesi, i adaptuari, te afermit ne vije te terthorte deri ne shkallen e katert , ne gjini te krushqise deri ne shkallen e dyte.

“Person i besueshëm” person që ka ose ka pasur mardhenje pasurore ose biznesi me zyrtarin.

“Zyrtar” për nevojat e këtij ligji nënkuptojmë personat sipas nenit 5 të këtij ligji.

“Agjencion” nënkupton Agjencionin Kosovar i Antikorrupsionit, themeluar me Ligjin nr. 2004/34 kundër korrupsionit (shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/26, datë 12.05.2005).

Fjala **“Agjencion”** ne tere tekstin e ligjit ndryshohet me fjalen **“Agjencia”** qe nenkupton Agjencine kunder Korrupsionit.

Neni 5 Zyrtari

Zyrtar në kuptim të këtij ligji janë këta ushtrues të funksionit publik:

I. Kryetari i Kuvendit dhe deputetët e Kuvendit të Kosovës;

II. Të gjithë ushtruesit e funksioneve publike të emëruar nga Kuvendi i Kosovës, që nuk përmenden shprehimisht në nenin 5 të këtij ligji;

III. Kryetari i Kosovës;

IV. Të gjithë ushtruesit e funksioneve publike të emëruar nga Kryetari i Kosovës, që nuk përmenden shprehimisht në nenin 5 të këtij ligji;

V. Kryeministri, zëvendëskryeministri, ministrat dhe zëvendësministrat e Qeverisë së Kosovës;

VI. Të gjithë ushtruesit e funksioneve publike të emëruar nga Qeveria, Kryeministri dhe ministrat e Qeverisë së Kosovës, që nuk përmenden shprehimisht në nenin 5 të këtij ligji;

VII. Kryetarët dhe gjyqtarët e gjykatave të të gjitha niveleve;

VII. Prokurorët publik dhe zëvendësprokurorët e të gjitha niveleve;

IX. Personat që kryejnë funksione publike në strukturat e rendit dhe sigurisë;

X. Personat e akredituar jashtë vendit si përfaqësues të Kosovës;

XI. Udhëheqësit e sekretarive dhe zyrave të tjera të Kryetarit të Kosovës, Kuvendit të Kosovës, Qeverisë së Kosovës;

XII. Sekretarët e përhershëm të kryeministrisë dhe të ministrive si dhe udhëheqësit e agjencive;

XII. Udhëheqësit e departamenteve, drejtorateve apo institucioneve tjera të nivelit qendror të krijuara me ligj apo akt tjetër, dhe vartësit e tyre të drejtpërdrejt në hierarkinë e institucionit, e që i përgjigjen për punën e tyre Kuvendit të Kosovës, Qeverisë së Kosovës apo ministrive/ave;

XIV. Kryetari, anëtarët e kuvendeve të Komunës dhe anëtarët e Komisioneve dhe trupave tjera të kuvendeve të Komunës;

XV. Drejtori i administrates dhe personelit;

XVI. Auditorët dhe inspektorët e nivelit qendror dhe lokal;

XVII. Guvernatori i Bankes qendrore dhe zevendesit e tij;

XVIII. Udhëheqësit e ndërmarrjeve publike;

XIX. Rektori, prorektori, anëtarët e këshillit drejtues, dekanët, prodekanët si dhe sekretarët e universitetit publik; dhe

XX. Personat e huaj që ushtrojnë funksion publik në Kosovë, sipas porosisë dhe për interes të Kosovës.

XXI. Komandanti i Forces se sigurise se Kosoves, Drejtori i Agjencise kosovare per intelegjence, drejtori i pergjitheshem i policise se Kosoves dhe zevendesit e tyre te cilet kane rol vendimarrës ne funksione publike te strukturave te rendit dhe te sigurise,

XXII. Drejtori i administrates tatimore te Kosoves, Drejtori i Dognave dhe vartesit e tyre kane rol vendimarrës

XXIII. Udheheqesit e Komisionit rregullativ te Prokurimit Publik dhe organit Shqyrtues te Prokurimit public,

XXIV, Udheheqesi i Agjensionit Kosovar te Privatizimit;

XXV. Te gjithë anetaret e bordeve te emeruara nga Kuvendi, Qeveria dhe Komunat,

XXVI. Te gjithë ushtruesit e funksioneve publike qe kane rol vendimares dhe nuk jane te cekur ne kete nen.

Neni 6 Konflikti i interesit

Konflikti i interesit është gjendja e mospajtimit ndërmjet detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, kur gjatë ushtrimit të funksionit të tij zyrtari ose personi i afërt ka interes privatë pasuror ose personal jo pasuror, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikon, ose mund të ndikoj në kryerjen në mënyrë të drejtë të funksionit publik, kur gjendet në situata të shkeljes së mundshme të parimeve, të kufizimeve dhe ndalesave apo detyrimeve, sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 7 Mënyra e sjelljes së zyrtarit

8.1. Zyrtari gjatë ushtrimit të funksionit publik duhet të veproj në mbrojtje të interesit publik dhe nuk ka të drejt që interesin e tij privat ta vërë para interesit publik, për mbrojtjen e të cilit është zgjedhur apo emëruar.

Neni 8 Parimet e veprimit të zyrtarit

9.1 Zyrtari duhet ta kryej punën e tij me ndershmëri, ndërgjegje, paanshmëri, të ruajë autoritetin e zyrtarit dhe institucionit dhe me punën e tij të rrisë besimin e qytetarëve në institucione.

9.2 Zyrtari ushtron funksionin e tij në pajtim me ligjin dhe kodin e mirësjelljes.

9.3 Zyrtari përgjigjet personalisht për veprimet e tij gjatë ushtrimit të funksionit në të cilin është emëruar apo zgjedhur nga institucioni apo qytetarët.

9.4 Zyrtari nuk ka të drejt të shfrytëzojë dhe duhet të përmbahet nga shfrytëzimi i funksionit publik për përfitim personal.

9.5 Zyrtari gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk ka të drejt të krijojë marrëdhënie varësie nga persona tjerë që do të mund të ndikonin në paanshmërinë dhe shprehjen e vullnetit të lirë në vendimmarrje.

9.6 Zyrtari për punën që kryen në ushtrimin e funksionit nuk ka të drejt të pranojë apo kërkojë shpërblim tjetër përveç kompensimit apo pagës nga institucioni.

9.7 Zyrtari nuk duhet të lejoj që interesat e tij private të bien në konflikt me funksionin e tij. Ai duhet të shmang konfliktin e interesit pavarësisht nëse ai është real, apo i mundshëm.

9.8 Zyrtari gjatë ushtrimit të funksionit të tij duhet të veprojë me transparencë duke respektuar të drejtën e organeve përfaqësuese dhe të drejtën e qytetarëve që të informohen për veprimet e zyrtarit si personalitet publik

Neni 9
Kufizimi i zyrtarit në ushtrimin e veprimtarive të tjera, jashtë ushtrimit të Funksionit

9.1. Personi zyrtar nuk duhet të ushtroj funksione administrative, mbikqyrese, apo perfaqesimi në shoqëritë tregtare, firma, institucione, kooperative, fonde apo agjencione.

9.2. Perjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, personi zyrtar mund si perfaqesues, i institucionit të tij të jetë anetar bordi i një institucioni apo Agjensioni public, apo anetar bordi mbikqyres të një ndërmarrjeje publike, fondi public apo shoqërie komerciale ku autoretiteti qendror apo lokal është mbajtësi i aksioneve apo i të drejtave të tjera në baze të cilave merr pjesë në menaxhim apo kapital.

Neni 10
Veprimet e ndaluara për zyrtarin

Zyrtarit në ushtrimin e veprimtarisë së tij i ndalohen këto veprime:

- I. të kërkojë apo pranoj shpërblim apo premtim shpërblimi lidhur me ushtrimin e funksionit;
- II. të fitojë ndonjë të drejtë, apo të pranoj premtim për fitimin e saj, në rastet kur shkelet parimi i barabarësisë para ligjit;
- III. keqpërdorimi i autorizimeve të cilat rrjedhin nga ushtrimi i funksionit publik;
- IV. të kërkojë, përvetësojë, pranojë gjëra me vlerë apo shërbime në kompensim të votës së tij në vendimmarrje;
- V. të ndikojë në vendimin e ndonjë zyrtari apo trupi për arsye të përfitimit material personal apo personit në lidhje me të;
- VI. të premtojë punësim apo ndonjë të drejtë tjetër në ndërrim për dhuratë apo dhuratë të premtuar;
- VII. të ndikojë në marrje - dhënie të punëve apo furnizimeve publike për përfitime personale;
- VIII. të shfrytëzojë informatat e besueshme që i ka në dispozicion apo të marra në mirëbesim në ushtrimin e funksionit për përfitime personale apo për përfitime të personave të afërt;
- IX. të ndikojë në vendimmarrje të organeve legjislativë, gjyqësore apo ekzekutive duke shfrytëzuar pozitën e zyrtarit me qëllim të përfitimit personal apo të personave të afërt;
- X. të ndër marr veprime të cilat në ndonjë mënyrë do t'i përshtaten interesit personal të tij apo interesit të personave të afërt;

XI. të ndërmarr veprime të cilat në ndonjë mënyrë do t'i përshtaten apo do të favorizonin interesin privat të ndonjë personi tjetër në dëm të interesit publik.

Neni 11

Kufizimet e zyrtarit pas largimit nga ushtrimi i funksionit publik

11.1 Zyrtari i cili përfundon ushtrimin e funksionit publik nuk ka të drejtë për 1 (një) vit të punësohet ose të emërohet në pozitë udhëheqëse, apo të përfshihet në kontrollin e ndërmarrjeve publike apo private, nëse detyrat e tij gjatë periudhës 2 (dy) vjeçare para përfundimit të ushtrimit të funksionit publik kanë qenë drejtpërdrejtë të lidhura me mbikëqyrjen apo kontrollin e afarizmit të atyre ndërmarrjeve.

11.2 Përjashtimet nga kufizimet sipas paragrafit 1 të këtij neni do të përcaktohen nga Agjencioni me akt nënligjor.

Neni 12

Ushtrimi i veprimtarive tjera nga zyrtari

12.1 Zyrtari i zgjedhur si përfaqësues i partisë politike ruan të drejtën e ushtrimit të funksionit në parti politike nëse me ligj të veçantë nuk është paraparë ndryshe.

12.2 Gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik, zyrtari mund të ushtrojë punë nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës dhe veprimtarisë humanitare.

12.3 Gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik, zyrtari mund të realizojë fitime në bazë të drejtave të autorit, patentat dhe të drejtave të ngjashme.

Neni 13

Anëtarësia e zyrtarit në organizata joqeveritare

13.1 Zyrtari mund të jetë anëtar i organit drejtues të organizatës joqeveritare nga lëmi i veprimtarisë humanitare, të kulturës, sportit dhe të ngjashme pa të drejtë pagese, përjashtimisht kompensimit për shpenzime të udhëtimit, dhe të ngjashme.

13.2 Organizata joqeveritare me anëtar të organit drejtues nga paragrafi 1 i këtij neni nuk mund të përfitoj mjete nga buxheti i Kosovës nëse anëtari i organit drejtues të organizatës joqeveritare, në cilësinë e zyrtarit, ka ndikim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në vendimmarrje, me rastin e vendosjes për Organizatat Joqeveritare përfituese nga mjetet e buxhetit të Kosovës.

Neni 14

Detyrimi i zyrtarit për parandalimin e konfliktit të interesit

14.1 Me zgjedhjen ose emërimin e tij, zyrtari ka për detyrë të parandalojë dhe të zgjidhë vetë, sa më parë dhe në mënyrën sa më efektive të mundshme, çdo situatë të konfliktit të tij të interesit.

14.2 Në rast se zyrtari është në mëdyshje për ekzistencën apo jo të një konflikti interesi të lidhur me të, ai duhet të këshillohet sa më parë me udhëheqësin e drejtpërdrejtë apo

organin udhëheqës.

14.3 Çdo udhëheqës dhe institucion udhëheqës duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dhe zgjidhur rastet e konfliktit të interesit.

14.4 Në rast se udhëheqësi apo institucioni udhëheqës nuk është i bindur për ekzistimin e konfliktit të interesit apo dyshon se edhe ai ka ose mund të ketë konflikt të interesit atëherë i drejtohet Agjencionit, për marrje të vendimit për rastin.

14.5 Zyrtarët udhëheqës të institucioneve, që nuk kanë udhëheqës të drejtpërdrejt për situatën e përshkruar në paragrafin 2 të këtij neni i drejtohen Agjencionit.

Neni 15

Ndikimi në vullnetin e zyrtarit

15.1 Nëse ndaj zyrtarit gjatë dhe lidhur me ushtrimin e funksionit publik ushtrohet ndikim i drejtpërdrejt apo i tërthortë, haptazi apo në mënyrë anonime për të votuar apo marr vendim të caktuar, duhet të njoftoj me shkrim udhëheqësin apo organin udhëheqës që të mënjanohen ndikimet mbi vullnetin e tij.

15.2 Rasti i tentimit të ndikimit në vullnetin e zyrtarit nga paragrafi 1 i këtij neni duhet ti lajmërohet institucionit që e ka zgjedhur apo emëruar si dhe Agjencionit i cili pas shqyrtimit do të vendos nëse ka nevojë ose jo të lajmërohet rasti organeve të ndjekjes.

15.3 Në rast tentim të ndikimit në vullnetin e zyrtarit, sipas paragrafit 1 të këtij neni zyrtari duhet të veproj në pajtim me ligjin duke ndërmarr këta hapa:

I. të refuzojë ofertën e tillë;

II. të provojë identifikimin e personit që ka bërë ofertën e tillë nëse oferta është anonime;

III. nëse është fjala për dhuratë e cila për shkak të rrethanave nuk mund të kthehet, zyrtari duhet menjëherë ta njoftojë me shkrim dhe ta dorëzojë të udhëheqësi mundësisht sa më shpejt, maksimalisht deri në 5 (pesë) ditë; si dhe

IV. të tregojë dëshmitarët e ndodhisë nëse kjo është e mundur.

15.4 Votimi dhe vendimi i marrë nën ndikim mbi vullnetin e zyrtarit është i pavlefshëm.

Neni 16

Bartja e të drejtave në drejtimin e ndërmarrjes

16.1 Zyrtari pronar i aksioneve gjegjësisht pjesës së kapitalit, në vlerë mbi 20%, të kapitalit të ndërmarrjes gjatë kohës së ushtrimit të funksionit duhet ti bart të drejtat në drejtimin e ndërmarrjes në ndonjë **person i besuar (në tekstin në vijim personi i besuar), por jo ne personat e aferte me zyrtarin.**

16.2 Personi i besuar nga paragrafi 1 i këtij neni do të veprojë në drejtim të realizimit të drejtave të anëtarit dhe të drejtave nga kapitali në emër të tij por për llogari të zyrtarit.

16.3 Nëse personi i besuar krijon marrëdhënie afariste me institucionet e qeverisjes qendrore apo lokale, me ndërmarrjet publike apo me ndërmarrjet ku kapitali i pronës publike ka më shumë se 25% të kapitalit apo aksioneve, është i detyruar që të njoftoj zyrtarin lidhur me marrëdhëniet e tilla afariste.

16.4 Gjatë kohës derisa të drejtat për administrim me ndërmarrjen i janë bartur personit tjetër, zyrtari nuk ka të drejtë të jap informata, udhëzime, urdhëresa apo në ndonjë mënyrë tjetër të qëndroj në lidhje me personin e besuar ashtu që të ketë ndikim në realizimin e të drejtave dhe përmbushjen e detyrave që dalin nga të drejtat e anëtarëve të ndërmarrjeve të tilla.

16.5 Zyrtari ka të drejtë që 1 (njëherë) në vit të informohet për ecuritë dhe gjendjen në ndërmarrjen ku ka pjesëmarrje, më shumë se një herë në vit mund të informohet për gjendjen në ndërmarrje vetëm sipasë kërkesës së aprovuar nga Agjencioni.

Neni 17 A

Mos pajtueshmeria me ushtrimin e funksionit public

17.A.1. Zyrtari nuk mund të jete menaxher apo anetar i ndonje organi menaxhues a kontrollues i ndermarrjeve private.

17.A.2. Perjashtimisht zyrtari mund të jete anetar i organit drejtues të ndermarrjes në pronesi publike apo shoqërisë aksionare me prona publike, mirepo pa të drejtë kompensimi apo pranimi të dhurates përveq të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve tjera të nevojshme.

17. A.3. Zyrtari ka të drejtë të jete anetar i organeve drejtuese dhe mbikqyresei personave juridik jo fitim prures dhe personave juridik tjere të cilat kryejne pune shkencore, humanitare, kulturore, sportive dhe veprimtarive të ngjashme, por pa të drejtë të pranimit të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve tjera të nevojshme.

17 A.4. Zyrtari i cili ushtron veprimtari të pavaruar , ndermarrje apo veprimtari tjetër fitimpruresë, është i detyruar të veproj në pajtim me nenin 15 të Ligjit.

17. A.5. Ndërmarrja në pronesi të zyrtarit, të personit të afërm ose të besuar, nuk ka të drejtë të lidhë kontrate ose të perfitoj ndihme nga institucionet qendrore ose lokale, net e cilat zyrtari është në pozite vendimmarrese.

Neni 18

Përgjegjësia për zbatimin e këtij ligji

Autoriteti qendror kompetent për zbatimin e këtij ligji është Agjencioni Kosovar i Antikorrupsionit.

Neni 19

Baza e veprimit të Agjencionit

Agjencioni vepron duke u bazuar në këtë ligj dhe në legjislacionin tjetër në fuqi lidhur me këtë qështje

Neni 20

Inicimi i procedurës nga Agjencioni

20.1 Procedura para Agjencionit fillon zyrtarisht nga Agjencioni, me kërkesën e udhëheqësit mbikëqyrës, organit mbikëqyrës të zyrtarit apo me kërkesën e vet zyrtarit.

20.2 Agjencioni mund ta fillojë procedurën në bazë të lajmërimit të ndonjë personi tjetër apo lajmërimit anonim.

20.3. Agjencia e onformon zyrtarin per fillimin e procedures dhe me kerkesen e tij e njofton me faktet qe posedon Agjencia.

20.4 Procedura nga Agjencioni është e mbyllur për publikun. Agjencioni i bën të njohura vetëm rezultatet përfundimtare të procedurës së zhvilluar.

20.5 Agjencioni në rast të dyshimit për ekzistimin e shkeljes do të njoftoj zyrtarin për të cilin ekziston dyshimi se ka bërë shkelje të rregullave të sjelljes të përcaktuara me këtë Ligj.

20.6 Agjencioni në mënyrë të pavarur i vërteton faktet, ndërsa institucionet tjera në kuadër të kompetencave të tyre janë të detyruara që pa shtyrje, sipas kërkesës së Agjencionit t'i vejnë në dispozim faktet dhe të dhënat e kërkuara.

Neni 21

Sanksionet për shkeljen e dispozitave të këtij ligji

21.1. Nese zyrtari bie ne kundeshitim me nenin 11 te ligjit, atehere zyrtari ndeshkohet sipas legjislacionit ne fuqi.

21.2. Kur zyrtari bie ne kundeshtim me nenin 8 te ligji dhe pasoja e veprimit te tij ka ndodhur, Agjencia kerkon nga instutacioni net e cilin zyrtari ushtron veprimtarine tij qe ndaj zyrtarit te filloj procedura e shkarkimit.

21.3. Nese shkelja nga paragrafi 2 I ketij neni ka demtuar interesin public, atehere Agjencia lajmeron rastin tek organet e ndjekjes.

21.4. Nese pas zgjedhjes, emertimit, ose konfirmimit te mandatiti personi zyrtar vazhdon te kryej nje aktivitetapo funksion qe ky ligj e percakton sit e papajtueshem me funksionin e ri, Agjencia e paralajmeron peronin zyrtar dhe vendose nej afat sipas te cilit atij do t'i kerkohet te nderprese aktivitetin apo te heqe dore nag posti. Afati i caktuar nga Agjencia nuk mund te jete me i shkurter se pesembedhjete dite apo me i gjate se tre muaj.

21.5. Ne rast se personi zyrtar i referuar ne paragrafin paraprak vazhdon te kryej aktivite apo funksione te papajtueshme, pavarisisht nga paralajmrimi i Agjencise, atehere Agjencia i propozon institucionit ku zyrtari ushtron funksionin qe ten is proceduren per shkarkimin e tij.

21.6. Organi competent ku personi zyrtar vazhdon te kryej nje aktivitet ose funksion te papajtueshem me ligjin, fillon proceduren per shkarkimin nga funksioni sipas propozimit te Agjencise. ne rastet kur deputeti i Kuvendit ushtron aktivitet te papajtueshem me ligjin per parandalimin e konfliktit te interesit ne ushtrimin e funksionit public, agjencia e njofton kryetarin e kuvendit per veprimin e deputetit qe ta nderprese aktivitetin e papajtueshem me ligjin. Lidhur me veprimet e ndermarra sipas propozimit te agjencise, institucionet kompetente menjehere duhet ta njoftojne agjencine.

Neni 22

Mos përjashtimi i përgjegjësive tjera ligjore

Dispozitat e këtij ligji nuk përjashtojnë përgjegjësinë disiplinore, materiale e penale të zyrtarit sipas ligjeve përkatëse për rastet që trajtohen nga Agjencioni sipas këtij ligji.

Neni 24

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Kosovës dhe 30 ditë shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Ndryshim plotesimet e ketije Ligji hynë ne fuqi pesembedhjet dite pas publikimit ne Gazeten Zyrtare te Republikës se Kosoves.

Ligji Nr. 02/L-133

Ligji Nr. 03/L-155

2 nëntor 2007 Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

19 nentor 2009

Kolë Berisha

Dr. Fatmir Sejdiu